REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/ 136
Datë: 07.03.2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d, nenit 40 paragrafi 2 pika d, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), bazuar në nenin 10, nenin 19, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e II (dytë) të vitit 2019 të mbajtur me datë:28.02.2019 merr këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR BUJQËSI PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2018

1. Miratohet Raporti i punës nr.02/12 datë:10.01.2019 i Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Malishevës për vitin 2018.

2. Raporti i punës për vitin 2018 përfshinë gjithë punën dhe aktivitetet e përcaktuara nga Komiteti për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural për vitin 2018.

3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Raporti i punës për vitin 2018.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kuvendi i Komunës, përmes Komitetit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Anëtarëve të Komitetit
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

FRANKIMI: 10-01-2019
ACCEPTED ON:
PRANUJENO:
Nr.No.Br. 02/12

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR BUJQËSI , PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL PËR VITIN 2018

PËR : Kryesusin e Asamblesë Komunale. Z. Rrahim Morina

NGA : Komiteti për Bujqësi ,Pylltari dhe Zhvillim Rural

Malishevë , Janar 2019

Komiteti për Bujqësi , Pylltari dhe Zhvillim Rural , është komitet jo obligativ , i themeluar ,me datë: 28.02.2018, me miratimin e asamblesë komunale .

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komiteti janë të punojnë , për të ndihmuar dhe përkrahur Bujqësinë në Komunen e Malishevës. Çdo herë duke mbajtur takime dhe duke diskutuar mënyrat e përkrahjes , eliminimin e pengesave, format e lehtësimit të atyre që mirrën me Bujqësi .

Komiteti përbëhet nga pesë (5) anëtarë, por komiteti ka funksionuar vetëm me tre (3) anëtarë , Kastriot Berisha PDK , Ismail Zogaj LDK, Dhe Adnan Zulfaj VV . Ndersa Nisma nuk i ka sjellë përfaqësuesit e vet .

Komiteti ka mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje , Dy (2) të rregullta , Një(1) të Jashtëzakonshme , dhe Një (1) Urgjente .

- Mbledhja e parë (I) ka qenë konstituimi i komitetit , me datë: 11.04.2018, në ora 11:05 dhe për rend dite ka pas:

1. Zgjedhja e Kryesusit të Komiteti

Të pranishëm ne këtë mbledhje ishin Kryesuesi I Kuvendit Komunal, tre (3) anëtarët e komitetit nga PDK, LDK dhe VV , si dhe Zyra për Informim.

Kryesues i komiteti për Bujqësi u zgjodh Kastriot Berisha nga PDK , i propozuar nga Ismail Zogaj nga LDK dhe përkrahur nga Adnan Zulfaj nga VV.

- Mbledhja e parë (I) e Jashtëzakonshme është mbajtur me datë : 29.08.2018, duke filuar nga ora 09:05 dhe morën pjesë Tre (3) anëtarët e komitetit si dhe Zyra për Informim , me rend dite :

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
2. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

Komiteti debatoj (shqyrtoj) raportin që ka sjellë drejtoria e Bujqësisë dhe erdhën në përfundim se ky raport është shumë i mangët dhe jo real si dhe me gabime të mëdha në shifra ku kemi mospërputhje prej mbi 100 mijë €.

Raporti nuk ka përfshirë asnjë listë të përfituesve, por janë paraqitur vetëm projekte dhe kostoja e projektit, për të qenë një raport i mirfilltë dhe i kopmletuar do të duhej të ishin edhe listat e përfituesve si dhe listat e aplikuesve , që ka qenë edhe kërkesë e komitetit të pajiset me këto lista .

Mirëpo komiteti për Bujqësi ka qenë çdoherë i injoruar karshi kërkesave ndaj kësaj drejtorie .

Ky raport u hodh poshtë me vota unanime nga komiteti për bujqësi për arsye të mos përputhjes së vlerave të projekteve dhe kostos totale ku diferenca ishte mbi 100 mijë € si dhe mos kompletimit me listat e përfituesve dhe aplikuesve

- Mbledhja e dytë (II) është mbajtur me datë : 21.11.2018 duke filluar nga ora 10:05 dhe morën pjesë Tre (3) antarët e komitetit , me rend dite :

1. Diskutimi I draft rregullores për tokat Bujqësore
2. Diskutimi I listave të përfituesve të Subvencioneve për vitin 2018

Komiteti u njoftua me draft rregulloren për tokat bujqësore të inicuar nga asambleistët e grupeve opozitare , dhe u kërkua të shqyrtohet si dhe në rast nevoje te bëhet plotësim dryshimi I kësaj rregullorje në mbledhjen e radhës .

Sa I përket pikës së dytë të rendit të ditës pra Listave të përfituesve të Subvencioneve për vitin 2018, këto lista nuk janë komplet dhe ne nuk kemi mundur t'i shqyrtojmë, sepse do të duhej të ishin edhe listat e aplikuesve që të shqyrtohen kriteret e përzgjedhjes së përfituesve se sa nga këta kush kanë plotësuar kriteret për të qenë përfitues të subvencionit .

Komiteti përsërit kërkesën për Listën e Aplikuesve për subvencione .

- Mbledhja e parë (I) urgjente u mbajtë me datë: 19.12.2018 duke filluar nga ora 10:00 dhe morën pjesë Tre (3) anëtarët e komitetit si dhe Zyra për Informim , me rend dite :

1. Diskutim I Draft Rrregullorës për tokat Bujqësora

Ku në këtë mbledhje komiteti erdhi me propozim për ndryshimin e emërtimit të kësaj draft rregullorje nga Draft Rregullorja për tokat bujqësore në Draft Rregullorën për Ndërrim- Destinimin të Tokës Bujqësore

Sfidat:

Sfidë e komitetit për Bujqësi është mos bashkëpunimi i Drejtorisë së Bujqësisë. Sikur të kishte bashkëpunim do të krijoheshin politika më të mira për zhvillimin e bujqësisë në komunën tonë

Rekomandimet :

Komiteti për bujqësi rekomandon që nga drejtoria për bujqësi të shqyrtohen politikat për zhvillimin e bujqësisë me subvencione zhvilluese për zhvillimin dhe përparimin e bujqësisë në komunën e Malishevës si she bashkëpunim të Drejtorisë së bujqësisë me Komitetin për Bujqësi.

Kryesues I Komitetit

Kastriot Berisha